



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2502, datë 22.09.2014

Për

“Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 22.09.2014, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse

B A Z A L I G J O R E:

1. Neni 7, gërma b) e nenit 8, neni 45, nenet 53-59, neni 110, 114 dhe neni 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, (*Ligji nr.9918, i ndryshuar*);
2. Vendimet e KD Nr. 2336-2339, datë 30-31.07.2013, për miratimin e dokumentit final të analizës së tregut të telefonisë fikse dhe përcaktimin e sipërmarrësve me FNT dhe masat përkatëse rreguluese.
3. Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik”, miratuar me Vendim nr.1183, datë 10.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP,

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- Projekt Vendimi;
- Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
- Dokumenti për Këshillim Publik;

si dhe, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke i'u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP nëpërmjet Vendimeve të KD Nr. 2336-2339, datë 30-31.07.2013, miratoi dokumentin final të analizës së tregut të telefonisë fikse dhe përcaktimin e sipërmarrësve me FNT dhe masat përkatëse për FNT. Në këto dokumnta dhe vendime AKEP vendosi midis të tjerave:
 - Reduktimin e segmenteve të tarifave të terminimit në rrjetin Albtelecom nga 3 në 2 duke aplikuar dhe 2 faza reduktimi të përshkallëzuar më 1.01.2014 dhe 1.09.2014;
 - Vendosjen nën-rregullim të tarifave të terminimit në rrjetet e të gjithë operatorëve të rrjeteve publike të telefonisë fikse, përfshirë AMC për terminimin e thirrjeve për pajtimtarët e telefonisë fikse AMC fiks.
 - Tarifat e interkoneksionit nën-rregullim pas datës 1.09.2014 të jenë në fuqi deri në një vendim tjetër të AKEP.
2. Nga informacionet e dërguara nga Albtelecom në AKEP vihet re se Albtelecom ka përfunduar procesin e migrimit në rrjetin NGN/NGA si dhe disa prej operatorëve kryesorë janë shprehur për thjeshtëzim të mënyrës së tarifimit për terminimin e thirrjeve në rrjetet publike të telefonisë fikse, për të kaluar në një segment tarifimi.
3. AKEP me Vendimet nr.2431-2435, datë 13.03.2014, përcaktoi orientimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve celularë sipas tarifës mesatare të vendeve Evropiane që kanë aplikuar LRIC të pastër në përputhje me *Rekomandimin e KE të datës 7 Maj 2009 mbi trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe celulare në BE (2009/396/EC)*. AKEP në dokumntin e Analizës së tregut celular të nxjerrë në këshillim publik më 23.07.2014 ka propozuar që ky nivel (1.48 lek/minutë sipas LRIC të pastër për rrjetet celulare) të arrihet më 1.01.2015 nga tre operatorët kryesorë celularë.
4. AKEP me Urdhërin nr.1257, datë 8.07.2014, ka ngritur një Grup Pune për “Për shqyrtimin e mundësive për rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet publike telefonike fikse”. Në vijim të këtij Urdhëri, AKEP njoftoi operatorët kryesorë të rrjeteve publike të telefonisë fikse për fillimin e procedurës dhe Grupi i Punës zhvilloi një takim paraprak me operatorët kryesorë më datë 31.07.2014. Në takim operatorët pjesmarrës dhanë disa opinione paraprake për çështje të tilla si:
 - Kalimin e segmenteve të tarifimit të terminimit nga 2 në 1;
 - Aplikimin ose jo të asimetrisë midis tarifës së terminimit të Albtelecom dhe operatorëve të tjerë të telefonisë fikse;
 - Numrin e pikave të interkoneksionit në rrjetin Albtelecom

5. Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin nr.1257, datë 8.07.2014, ka përgatitur dokumentin: *Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse*. Dokumenti i përgatitur përmban midis të tjerave:
 - një historik të ecurisë së nivelit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse në Shqipëri;
 - tarifatat mesatare në vendet e BE dhe rajonit (sipas publikimeve të KE dhe BEREC)
 - propozimin për rishikimin e nivelit të tarifave të terminimit fikse në Shqipëri
 - efektet e pritshme të reduktimeve të propozuara të tarifave të terminimit fikse
6. Grupi i Punës në përgatitjen e dokumentit të përgatitur ka marrë në konsideratë:
 - Të dhënat e Komisionit Evropian të publikuara për Axhendën Dixhitale të BE
 - Të dhënat e publikuara nga BEREC për tarifatat e terminimit në rrjetet fikse
 - Rekomandimin e Komisionit Evropian të datës 7 Maj 2009 (2009/396/EC)
 - Të dhëna të publikuara nga Cullen International në lidhje me aplikimin e LRIC të pastër
 - Kushtet aktuale të tregut fikse në Shqipëri
 - komentet paraprake të shprehura nga operatorët në takimin e datës 31.07.2014
7. AKEP, vlerëson se dokumenti për këshillim publik, *“Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse”*, përbën një dokument të rëndësishëm rregullator për realizimin e objektivave të AKEP për nxitjen e stimujve nga operatorët e rrjeteve fikse në modernizimin e rrjeteve për ofrim shtesë të shërbimesh telefonike dhe akses broadband dhe rritjen e konkurrencës në tregun fikse, dhe është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, duke marrë në konsideratë rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Evropian dhe BEREC-ut
8. Për këtë qëllim, AKEP në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe në përputhje me Udhëzuesin e Procedurave për Këshillimin me Publikun miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 1183, datë 10.03.2010, në kuadër të transparencës çmon si të arsyeshme nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit *“Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse”*.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke marrë në konsideratë rëndësinë e publikimit të dokumentit të cituar, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë për Këshillim Publik dokumentin *“Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse”*, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Periudha e Këshillimit Publik të jetë 30 ditë nga data e publikimit të dokumentit në Internet në faqen zyrtare të AKEP;

3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Rishikimi
i tarifave të terminimit të thirrjeve
në rrjetet fikse

Dokument per Këshillim Publik

Shtator 2014

(Miratuar me VKD nr. ___ datë ___ 2014)

(Publikuar si dokument me vehte në seksionin Konsultime në proces: www.akep.al)



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**Rishikimi
i tarifave të terminimit të thirrjeve
në rrjetet fikse**

Dokument per Këshillim Publik

Shtator 2014

(Miratuar me VKD nr.2502 datë 22.09.2014)

Tabela e Përmbajtjes

1.	Hyrje	3
2.	Ecuria e nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet fikse në Shqipëri	5
3.	Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe tarifrat mesatare të terminimit në BE dhe rajon.....	7
3.1.	Rekomandimi i KE 2009/396/EC, datë 7 Maj 2009	7
3.2.	Niveli mesatar i tarifave të terminimit në vendet e BE dhe rajonit	8
3.2.1.	Tarifrat mesatare në vendet e BE të publikuara nga KE	8
3.2.2.	Tarifrat mesatare të terminimit fiks sipas BEREC.....	10
3.2.3.	Tarifa mesatare e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër.....	14
3.2.4.	Interkoneksioni në nivel IP	15
3.2.5.	Përmbledhje e tarifave mesatare (benchmark)	16
4.	Rishikimi i nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet fikse në Shqipëri	18
5.	Efektet e pritshme	21
	Aneks 1: Lista e Shkurtimeve të Shteteve	23
	Aneks 2: Lista e pyetjeve për këshillim publik	24

Lista e Tabelave dhe Figurave

TABELA 1: VLERAT E TARIFAVE TARIFAVE TË TERMINIMIT/ORIGJINIM/TRANZITIMIT NË ALBTELECOM 2013-2015	5
TABELA 2: VLERAT MAKSIMALE TE TARIFAVE TË TERMINIMIT NE RRJETET E OPERATOREVE ALTERNATIVE FIKS 2013-2015	6
TABELA 3: : VLERAT MAKSIMALE TE TARIFAVE TË TERMINIMIT NE RRJETIN AMC PER THIRRJET DREJT AMC FIKS 2013-2015	6
TABELA 4: TARIFAT E TERMINIMIT NË RRJETET FIKSE NË VENDET E BEREC MË 1.01.2014	12
TABELA 5: TARIFAT E TERMINIMIT FIKS DHE APLIKIMI I LRIC I PASTËR 2013-2015	15
TABELA 6: VLERAT MESATARE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT CELULAR (BENCHMARK)	17
TABELA 7: TARIFAT E TERMINIMIT TË THIRRJEVE NË RRJETIN FIKS ALBTELECOM (2010-2016)	18
TABELA 8: TARIFAT E TERMINIMIT TË THIRRJEVE NË RRJETET FIKSE TË OA DHE AMC PËR AMC FIKS (2010-2016)	20
TABELA 9: NDRYSHIMET NË PËRQINDJE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT NË RRJETET FIKSE (1.09.2014-1.01.2016).....	21
FIGURA 1: TARIFAT MESATARE TË TERMINIMIT NË VENDET E BE (JANAR 2013 DHE JANAR 2014).....	9
FIGURA 2: TARIFAT MESATARE TË TERMINIMIT SIPAS VENDEVE NË JANAR 2014	11

1. Hyrje

AKEP në analizën e fundit të tregut të telefonisë fikse dhe Vendimet e KD Nr. 2336-2339, datë 30-31.07.2013, për miratimin e dokumentit final të analizës së tregut dhe përcaktimin e sipërmarrësve me FNT dhe masat përkatëse rregulluese vendosi midis të tjerave:

- Reduktimin e segmenteve të tarifave të terminimit në rrjetin Altelecom nga 3 në 2 duke aplikuar dhe 2 faza reduktimi të përshkallëzuar më 1.01.2014 dhe 1.09.2014;
- Vendosjen nën-rregullim të tarifave të terminimit në rrjetet e të gjithë operatorëve të të rrjeteve publike të telefonisë fikse, përshirë AMC për terminimin e thirrjeve për pajtimtarët e telefonisë fikse AMC fiks.
- Tarifat e interkoneksionit nën-rregullim pas datës 1.09.2014 të jenë në fuqi deri në një vendim tjetër të AKEP.

AKEP në përcaktimin e nivelit të tarifave të terminimit në rrjetin e Altelecom gjykoj se:

- *Pavaresisht migrimit të plotë në rrjetin NGN të Altelecom, për një periudhë tranzitore deri në kalimin e plotë në interkoneksion në nivel IP, do të ketë bashkëzistencë të dy rrjeteve PSTN/TDM dhe NGN/NGA dhe sic është theksuar me parë në këtë dokument ky është një konstatim i Altelecom dhe praktike edhe në vende të tjera.*
- *Ndryshimet që duhet të kryhen në interkoneksion për kalimin e plotë të tij në nivel IP kanë një sërë implikimesh që do të duhet të diskutohen edhe me operatorët e tjerë në treg, të tilla si menyra e interkonektimit (TDM-IP; IP-IP etj), pikat e interkonektimit, menyrën e pagesës (CPP/RPP/Bill and Keep), cilesinë e shërbimit, standartet e perdorura etj.*
- *Reduktimi i segmenteve të terminimit/origjinimit nga 3 në 2 si dhe tranzitimit nga 2 në 1 mund të kryhen duke filluar nga 1 Janar 2014 ndërkohë kalimi në 1 segment terminimi/origjinimi do të diskutohet edhe me lojtarët e tregut dhe në kuadër të ndryshimeve në interkoneksion për kalimin në nivel IP.*
- *Vlerat e tarifave të interkoneksionit të Altelecom të jenë sipas vlerave të propozuara në konsultim publik, duke eliminuar fazën e tretë ku arrihet me një segment si dhe duke zhvendosur në kohë Fazën I dhe II. Faza I do të fillojë më 1.01.2014.*

Nga informacionet e dërguara nga Altelecom në AKEP vihet re se Altelecom ka përfunduar procesin e migrimit në rrjetin NGN/NGA si dhe disa prej operatorëve kryesorë janë shprehur për thjeshtëzim të mënyrës së tarifimit për terminimin e thirrjeve në rrjetet publike të telefonisë fikse, për të kaluar në një segment tarifimi.

AKEP me Vendimet nr.2431-2435, datë 13.03.2014, përcaktoi orientimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve celularë sipas tarifës mesatare të vendeve Evropiane që kanë

aplikuar LRIC të pastër në përputhje me *Rekomandimin e KE të datës 7 Maj 2009 mbi trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe celulare në BE (2009/396/EC)*. AKEP në dokumnetin e Analizës së tregut celular të nxjerrë në këshillim publik më 23.07.2014 ka propozuar që ky nivel (1.48 lek/minutë sipas LRIC të pastër për rrjetet celulare) të arrihet më 1.01.2015 nga tre operatorët kryesorë celularë.

AKEP me Urdhërin nr.1257, datë 8.07.2014, ka ngritur një Grup Pune për “Për shqyrtimin e mundësive për rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet publike telefonike fikse”. Në vijim të këtij Urdhëri, AKEP njoftoi operatorët kryesorë të rrjeteve publike të telefonisë fikse për fillimin e procedurës dhe Grupi i Punës zhvilloi një takim me operatorët kryesorë më datë 31.07.2014. Në takim operatorët pjesëmarrës dhanë disa opinione paraprake për çështje të tilla si:

- Kalimin e segmenteve të tarifimit të terminimit nga 2 në 1;
- Aplikimin ose jo të asimetrisë midis tarifës së terminimit të Albtelecom dhe operatorëve të tjerë të telefonisë fikse;
- Numrin e pikave të interkoneksionit në rrjetin Albtelecom

Operatorët pjesëmarrës në takim kishin mendime të ndryshme, megjithatë u vu re të gjithë operatorët pjesëmarrës ishin dakort për kalimin nga 2 segmente në 1 segment tarifimi për terminimin e thirrjeve si dhe afrimin në kohë të këtij reduktimi, duke filluar mundësiht nga 1.01.2015.

AKEP me publikimin e këtij dokumenti për këshillim publik propozon rishikimin e nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet publike të telefonisë fikse duke u bazuar në zhvillimet e ndodhura dhe pritshmëritë e operatorëve si dhe në përvojat ndërkombëtare për këtë çështje, duke e përshtatur me kushtet e tregut Shqiptar për telefoninë fikse që karakterizohet nga një penetrim dhe përdorim i ulët në krahasim me vendet e BE dhe të rajonit, karakteristikë e ndryshme nga telefonia celulare që ka ngjashmëri me vnedete tjera Evropiane për tregues të tillë si penetrimi, mbulimi, niveli i tarifave etj.

Qëllimi i rishikimit është përmbushja e objektivave rregullatore për nxitjen e investimeve nga operatorët e rrjeteve fikse dhe rritjen e konkurrencës në treg dhe maksimizimin e përfitimeve të përdoruesve nga shërbimet telefonike fikse dhe shërbimet e rrjeteve fikse më gjerë si aksesit broadband nga rrjete fikse.

2. Ecuria e nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet fikse në Shqipëri

Niveli i tarifave të terminimit (si dhe origjinimit dhe tranzitimit) në rrjetin e telefonisë fikse të Albtelecom ka qene objekt rregullimi nga AKEP (më parë ERT) që nga viti 2006. Rregullimi i këtyre tarifave nga AKEP është kryer duke përdorur nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE, dhe rajonit.

Në dokumentin e Analizes së tregut të telefonisë fikse, miratuar më 30.07.2013, dhe me vendimet përkatëse të FNT (30-31.07.2014), AKEP ka miratuar nivelin e tarifave të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit për Albtelecom dhe tarifatat e terminimit për operatorët alternativë fiks, përfshirë AMC për AMC fiks, të përcaktuar me FNT. Tarifatat e përcaktuara në këto vendime dhe afatet kohore të aplikimit të tyre janë dhënë në tabelat e mëposhtëme.

Tabela 1: Vlerat e tarifave tarifave të terminimit/origjinimit/tranzitimit në Albtelecom 2013-2015

	1.09.2010	Faza I	Faza II	Ndryshimi	
		1.01.2014	1.09.2014- deri ne nje Vendim tjetër te AKEP	Faza I/2010- 2013	Faza II/2010- 2013
Terminim – Origjinim (lek/minute)					
Lokal	1.50	1.34	1.19	-11%	-21%
Njefish	2.50	1.34	1.19	-46%	-52%
Dyfish	3.50	2.68	1.85	-24%	-47%
Tranzitim(lek/minute)					
Njefish	1.50	1.71	1.32	14%	-12%
Dyfish	2.50	1.71	1.32	-32%	-47%
Tarife per thirrje	0.83	0.53	0.38	-36%	-54%

Shenim: Tarifatat jane pa TVSH.

Tabela 2: Vlerat maksimale te tarifave të terminimit ne rrjetet e operatoreve alternative fikse 2013-2015

	1.09.2010	Faza I	Faza II
		1.01.2014	1.09.2014- deri ne nje Vendim tjetër te AKEP
Tarifa lek/minute			
Lokal	1.5-1.95	1.50	1.34
Mesatare-Njefish/dyfish	2.5-3.25/3.5	2.42	1.77
Tarifë fikse për thirrje (lek/thirrje)	0.83	0.53	0.38

Shenim: Tarifat jane pa TVSH.

Tabela 3: : Vlerat maksimale te tarifave të terminimit ne rrjetin AMC per thirrjet drejt AMC Fiks 2013-2015

	1.09.2010	Faza I	Faza II
		1.01.2014	1.09.2014- deri ne nje Vendim tjetër te AKEP
Terminimi lek/minute	1.50 ose 2.5	1.34	1.19
Tarife fikse per thirrje		0.53	0.38

Shenim: Tarifat jane pa TVSH.

3. Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe tarifatat mesatare të terminimit në BE dhe rajon

3.1. Rekomandimi i KE 2009/396/EC, datë 7 Maj 2009

Komisioni Evropian, ERG (sot BEREC) në dokumenta të ndryshme ndër vite në lidhje me rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare, kanë rekomanduar përdorimin e modeleve LRIC (BU, TD apo kombinim të tyre). Komisioni Evropian në rekomandimin më të fundit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit, *Rekomandimi i KE i datës 7 Maj 2009 mbi trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe celulare në BE (2009/396/EC)*, ka rekomanduar autoriteteve rregullatore, midis të tjerave:

- Përcaktimin e tarifave të terminimit bazuar në kostot e ofrimit nga një operator eficient. Kjo nënkupton gjithashtu që tarifatat duhet të jenë simetrike;
- Vlerësimi i kostove eficientë të bazohet në kostot korrente dhe përdorimin kostove afatgjate inkrementale me metodën BU, si metodologjia e duhur e kostove;
- Rregullatorët mund të përdorin krahasimin e rezultateve të modelit BU me model TD i cili përdor të dhëna të audituara për të përmirësuar konsistencën e rezultateve dhe mund të bëjnë rregullimet e nevojshme;
- Si inkrement të përdoret shërbimi me shumicë i terminimit që i shitet operatorëve të tjerë dhe jo gjithë shërbimet si në rastin LRIC;
- Asimetri mund të përdoret në raste kur mund të demonstron se hyrësit e rinj kanë dizavantazh në raport me operatorët e tjerë.

Zgjedhjet e dhëna nga KE në këtë rekomandim kanë ndikim në rezultatet e modeleve BULRIC të aplikuar më parë, dhe modeli i llogaritjes së kostove me zgjedhjet e përfshira në këtë rekomandim tashme njihet si LRIC i pastër (pure LRIC).

Ky rekomandim është zbatuar gjerësisht tashmë në vendet e BE dhe njëkohësisht ka filluar implementimi edhe në disa vende të rajonit, për sa i përket tarifave të terminimit në rrjetet

celulare. Ndërkohë për terminimin e thirrjeve në rrjetet fikse aplikimi në vitin 2013 ishte më i kufizuar së në rrjetet celulare. Seksioni 3.2.3 trajton aplikimin LRIC të pastër në Evropë.

3.2. Niveli mesatar i tarifave të terminimit në vendet e BE dhe rajonit

Për sa i përket nivelit të tarifave mestare të aplikuara në vendet e BE dhe në rajon, AKEP ka grumbulluar informacion duk iu referuar burimeve të mëposhtëme:


- Të dhënat e Komisionit Europian të publikuara për Axhendën Dixhitale të BE¹ (Financial indicators fixed and mobile telephony broadcasting and bundled services indicators);
- Të dhënat e publikuara nga BEREC për tarifrat e terminimit në rrjetet celulare (Janar 2014).
- Të dhëna të publikuara nga Cullen International në lidhje me aplikimin e LRIC të pastër

3.2.1. Tarifrat mesatare në vendet e BE të publikuara nga KE


Të dhënat më të fundit të publikuara nga KE në lidhje me tarifrat e terminimit në vendet e BE, përmbajnë tarifrat e aplikuara në 27 vendet anëtare të BE, duke iu referuar situatës deri më 1 Janar 2014. Këto të dhëna janë paraqitur në Figurë 1, më poshtë sipas tre segmenteve që aplikohen normalisht për terminimin e thirrjeve në rrjetet fikse.


¹ <http://ec.europa.eu/digital-agenda/en/download-data>

Figura 1: Tarifatat mesatare të terminimit në vendet e BE (Janar 2013 dhe Janar 2014)



Burimi: EC Digital Agenda for Europe.





Burimi: EC Digital Agenda (Financial indicators fixed and mobile 2014)

Tarifa mesatare në vendet e BE në Janar 2014 sipas 3 segmenteve ishte:



- 0.41 eurocent/minutë për segmentin 1 (local)
- 0.43 eurocent/minutë për segmentin 2 (rajonal apo njëfish)
- 0.63 eurocent/minutë për segmentin 3 (kombëtar apo dyfish)


Reduktimi varion nga 18-26% në krahësim me vitin 2013.

3.2.2. Tarifat mesatare të terminimit fiks sipas BEREC

BEREC (më parë ERG) kryen publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse. Publikimet janë cdo gjashtë muaj dhe publikimi më i fundit paraqet situatën e tarifave të terminimit në Janar 2014 në 34 vende Evropiane. Në këtë listë përfshihen 27 vendet anëtare të BE plus 7 vende të tjera Evropiane, përfshirë disa vende me status kandidat për anëtar në BE. Figura e mëposhtme paraqet tarifën e terminimit në rrjetet fikse sipas 3 segmenteve më 1 Janar 2014.

Figura 2: Tarifate mesatare të terminimit sipas vendeve në Janar 2014





Burimi: BEREC BoR (14) 55

Sipas të dhënave të mësipërme tarifa mesatare në vendet e BEREC në Janar 2014 sipas 3 segmenteve ishte:

- 0.41 eurocent/minutë për segmentin 1 (local)
- 0.47 eurocent/minutë për segmentin 2 (rajonal apo njëfish)
- 0.64 eurocent/minutë për segmentin 3 (kombëtar apo dyfish)

Vihet re se tarifat mesatare në vendet e BE dhe BEREC janë shumë të përafërta dhe pa ndryshime të ndjeshme sipas të 3 segmenteve.

Tabela e mëposhtëme parqet tarifat e terminimit në rrjetet fikse sipas segmenteve të aplikuara. Në tabelë janë vënë në dukje vendet që aplikojnë vetëm një segment për terminimin e thirrjeve.

Tabela 4: Tarifat e terminimit në rrjetet fikse në vendet e BEREC më 1.01.2014

Vendi	Layer	Vlera (Eurocent/min)
AT	Layer 1	0.1110
BE	Layer 1	0.4717
	Layer 2	0.6665
	Layer 3	0.8548
BG	Layer 1	0.2600
CH	Layer 2	0.7838

	Layer 3	0.6219
CY	Layer 1 (1)	0.3420
	Layer 1 (r)	0.5470
	Layer 2	0.6320
CZ	Layer 1	0.8440
	Layer 2	0.9566
DK	Layer 1	0.0836
	Layer 2	0.0836
	Layer 3	0.5220
DE	Layer 1	0.3000
EE	Layer 1	0.6913
	Layer 3	0.9760
EL	Layer 1	0.2190
	Layer 2	0.4310
	Layer 3	0.5370
ES	Layer 1	0.3500
	Layer 2	0.4500
	Layer 3	0.8500
	Layer 4	0.6500
FL	N/A	2.4000
FR	Layer 1	0.0800
HR	Layer 1	0.2891
	Layer 2	0.4191
	Layer 3	0.7945
HU	Layer 1	0.1345
	Layer 2	0.1345
	Layer 3	0.1345
IE	Layer 1	0.0982
	Layer 2	0.5080
	Layer 3	0.6260
IS	Layer 1	0.5126
IT	Layer 1	0.1040
	Layer 2	0.1040
LV	Layer 1	0.9676
LT	Layer 3	0.6111
LU	Layer 1	0.5533
	Layer 2	0.7233
FYROM	Layer 1	0.4715

	Layer 2	0.4878
	Layer 3	0.5853
MT	Layer 1	0.2722
NL	Layer 2	0.3020
NO	Layer 1	0.3156
	Layer 1	0.4935
PL	Layer 2	0.5861
	Layer 3	0.8630
	Layer 1	0.1026
PT	Layer 2	0.1411
	Layer 3	0.1642
	Layer 3	0.7300
RO	Layer 2	0.6700
	Layer 1	0.5800
	Layer 3	0.8134
RS	Layer 2	0.7872
	Layer 1	0.6035
	Layer 1	0.0745
SE	Layer 2	0.1208
	Layer 1	0.3900
SI	Layer 2	0.6800
	Layer 3	0.9500
	Layer 1	0.1234
SK	Layer 2	0.1234
	Layer 3	0.1234
UK	Layer 1	0.0416
	Layer 1	0.5048
TR	Layer 2	0.6210
	Layer 3	0.8135

Burimi: BEREC BoR (14) 55

3.2.3. Tarifa mesatare e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër

Tabela e mëposhtëme paraqesin vlerat e tarifave të terminimit në 34 vendet që raporton BEREC, që kanë aplikuar LRIC të pastër për tarifatat e terminimit në rrjetet fikse në 2013/2014 dhe ato që

kanë marrë vendime/propozuar për aplikim deri në 2015. Informacioni është marrë nga raportet e BEREC të përmendura në seksionin e mëparshëm dhe Cullen International².

Tabela 5: Tarifat e terminimit fiks dhe aplikimi i LRIC i pastër 2013-2015

Vendi	Data e aplikuar/propozuar	Vlera e aplikuar/propozuar (ne Eurocent)
AT	01.11.2013	0.1220
BG	01.07.2013	0.2600
CZ	07.05.2014	0.1100
DK	01.01.2013	0.0500
ES	pavendosur	0.0862
GR	28.05.2014	0.0735
HR	01.01.2015	0.0800
HU	01.01.2014	0.1300
IE	01.07.2013	0.1000
IT	01.07.2015	0.0430
LT	pavendosur	0.2500
NL	01.09.2013	0.1080
RO	01.04.2014	0.1400
SE	01.01.2014	0.0800
SK	01.09.2013	0.1234
UK	01.01.2014	0.0400
Mesatare 'Pure' LRIC	Eurocent	0.1123
	Lek	0.1572

Shenime: 1. Tarifat janë pa TVSH 2. Kursi i Këmbimit i përdorur 1 Euro=140 Lek

Burimi: BEREC, Cullen International, AKEP

3.2.4. Interkoneksioni në nivel IP

Operatorët e rrjeteve telefonike fikse në Evropë janë në procese të migrimit nga rrjet PSTN (komutim në qark) në rrjet NGN me rrjet bazë (core netëork) bazuar në IP, me komutim paketash

² Fixed termination rates – Moving towards pure LRIC? Update June/July 2014

që bartin trafik zonor, të dhëna dhe video. Rrjete të tilla të konverguara zvogëlojnë koston e transportit të trafikut dhe menaxhimin e rrjetit. Trafiku zonor pritet që në të ardhmen të transmetohet I gjithë në IP midis pikave fundore. Megjithatë sic është theksuar dhe në analizën e tregut fiks në faza tranzicionale operatorët vazhdojnë të përdorin pajisje të rrjetit tradicional të aksesit dhe TDM (time division multiplexing) për interkoneksion. Një operator mund të përdorë IP (VoIP apo VoB) për pajtimatrët dhe trafikun brenda rrjetit por në interkoneksion trafiku IP konvertohet në PSTN, dhe anasjelltas, duke përdorur porta mediale (media gateways). Migrimi drejt rrjeteve NGN con edhe në interkoneksion në nivel IP për trafikun zonor.

Megjithatë interkoneksioni në nivel IP për trafikun e menaxhuar zonor ka ndryshim nga interkonektimi i ISP-ve (i cili është i pa-rregulluar dhe me forma të ndryshme si transit IP, peering apo kombinim i tyre) pasi shërbimet zanore të menaxhuara bazohen jo vetëm në konektivitetin Internet por edhe në burime të dedikuara të rrjetit.

Në disa vende evropiane ka filluar tashmë interkoneksioni në nivel IP edhe për trafikun zonor. Në shumicën e këtyre vendeve për operatorët fiks (kryesisht incumbent) është vendosur detyrim për të ofruar interkoneksion IP për trafikun zonor, ndërsa në disa vende nuk ka detyrim megjithëse mund të ndodhe në praktikë.

Kalimi në NGN në disa vende është shoqëruar me reduktim të ndjeshëm të pikave të interkoneksionit dhe njëkohësisht me reduktim të ndjeshëm të tarifave të terminimit (aplikohet vetëm një tarifë).

AKEP gjykon që të ketë qasje të kujdeshme në lidhje me vendosjen e detyrimeve për kalimin e interkoneksionit në nivel IP dhe reduktimin e mëtejshëm të pikave të interkoneksionit të Albtelecom në mënyrë të shpejtë. Kjo qasje është e justifikuar nga karakteristikat e tregut të telefonisë fikse në Shqipëri. Në seksionet në vijim AKEP ka parqitur propozimin për tarifën dhe pikat e interkoneksionit të Albtelecom, duke gjykuar që diskutimet për detyrime për interkoneksion në nivel IP të kryhen në analizën e rradhës të tregut të telefonisë fikse në 2015.

3.2.5.Përmbledhje e tarifave mesatare (benchmark)

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të tarifave mesatare benchmark të diskutuara në seksionet e mëparshme.

Tabela 6: Vlerat mesatare të tarifave të terminimit celular (benchmark)

		Eurocent/minute	Lek/minute
BE	Segment 1	0.41	0.57
	Segment 2	0.43	0.60
	Segment 3	0.63	0.88
	MESATARE e 3 segmenteve	0.49	0.69
BEREC	Segment 1	0.41	0.57
	Segment 2	0.47	0.66
	Segment 3	0.64	0.90
	MESATARE e 3 segmenteve	0.51	0.71
LRIC e pastër		0.11	0.16
BEREC mesatare e vendeve me 1 Segment		0.48	0.68

Burimi: BEREC, Cullen International, AKEP

Nga tabela vihet re se:

- Tarifat mesatare të terminimit në vendet e BE dhe BEREC janë 0.57- 0.90 lek/minutë sipas 3 segmenteve;
- Tarifa mesatare e vendeve të BEREC që aplikojnë vetëm një segment për terminimin fiks është 0.68 lek/minutë
- Tarifa mesatare e vendeve të BEREC që kanë aplikuar LRIC të pastër është 0.16 lek/minutë;
- Tarifa mesatare e 3 segmenteve në BE dhe BEREC është 0.69 dhe 0.71 lek/minutë, përkatësisht.

4. Rishikimi i nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet fikse në Shqipëri

Bazuar në zhvillimet e fundit dhe kushtet e tregut të telefonisë fikse në Shqipëri, si dhe zhvillimet në vendet e rajonit dhe BE, AKEP gjykon që tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve të rrjeteve fikse të rishikohen me qëllim aplikimin e një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve në rrjetet e operatorëve të rrjeteve fikse. AKEP gjykon që të përdorë metodën e rregullimit sipas tarifës mesatare në vendet e BE/rajonit (benchmark) duke përdorur një reduktim të përshkallëzuar (glide path).

Tabela e mëposhtme paraqet propozimin e AKEP për tarifat e terminimit të Altelecom si dhe numrin e pikave të interkoneksionit për periudhën 2010-2016.

Tabela 7: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetin fiks Altelecom (2010-2015)

	1.09.2010	1.01.2014	1.09.2014	1.01.2015	1.07.2015	Ndryshimi 2015/aktuale
Terminim – Origjinim (lek/minute)						
Lokal	1.5	1.34	1.19	1.52	0.7	
Njëfish	2.5					-41%
Dyfish	3.5	2.68	1.85			-62%
Tranzitim (lek/minute)						
Njëfish	1.5	1.71	1.32	0.93	0.43	
Dyfish	2.5					-68%
Tarife per thirrje (lek/thirrje)	0.83	0.53	0.38			0.23
POI	84	12	12	12	2	

Tarifat pa TVSH

Vlerat e tabelës së mësipërme janë përcaktuar si më poshtë:

- Tarifa e terminimit/origjinimit nga 1.01.2015 është përcaktuar si tarifa mesatare e dy segmenteve të aplikuara duke filluar nga 1.09.2014;

- Tarifa e terminimit më 1.07.2015 është sa tarifa mesatare e vendeve të BEREC që aplikojnë një segment dhe sa mesatarja e tre segmenteve në vendet e BEREC dhe BE, më 1.01.2014.
- Tarifa e tranzitimit duke filluar nga 1.01.2015 është përcaktuar sa tarifa e propozuar nga AKEP në konsultimin publik të analizës së tregut fiks në 2012;
- Tarifa e tranzitimit nga 1.07.2015 është 0.43 lek/minutë që përbën reduktim me 54% nga periudha e mëparshme, e njëjtë me masën e reduktimit të tarifës së terminimit.
- Tarifa për thirrje reduktohet në 0.23 lek/thirrje më 1.01.2015 dhe hiqet më 1.07.2015.
- Numri i pikave të interkoneksionit (POI) të Altelecom qëndron në 12 më 1.01.2015 dhe reduktohet në 2 më 1.07.2015.

Tarifa e terminimit në rrjetin Altelecom më 1.07.2015 propozohet të arrijë vlerën 0.7 lek/minutë, që është sa tarifa mesatare e terminimit e vendeve të BEREC që aplikojnë një segment (13 vende) si dhe sa mesatarja e tre tarifave mesatare të vendeve të BE dhe BEREC, më 1.01.2014. Në fazën e parë që fillon më 1.01.2015 kryhet kalimi në një segment tarifimi. Në këtë fazë (6 muaj) ka një rritje të tarifës së terminimit në segment local/njëfish, por kjo kompensohet nga reduktimi i tarifës në segment dyfish si dhe reduktimi i tarifës për thirrje. Reduktimi në Korrik 2015 në raport me tarifën aktuale është 41-62% për tarifën e terminimit dhe 68% për tarifën e tranzitimit.

Pikat e Interkoneksionit të Altelecom

Numri i pikave të interkoneksionit propozohet të vazhdojë të jetë 12 edhe për gjashtëmuajorin e parë 2015, ndërsa duke filluar nga 1.07.2015 ky numër propozohet të reduktohet në 2, në centralet softswitch të Altelecom në Tiranë dhe Durrës. Reduktimi i pikave të interkoneksionit vjen si rezultat i migrimit të rrjetit Altelecom nga PSTN në NGN dhe është një proces që ka ndodhur dhe po ndodh dhe në vende të tjera. Këtë proces AKEP e ka parashikuar edhe në Analizën e tregut fiks të miratuar më 30.07.2013.

Periudha prej më shumë se 6 muaj gjykohet e mjaftueshme për operatorët alternativë për t'u përshtatur me reduktimin e pikave të interkoneksionit. Efekti nuk pritet të jetë i madh pasi ai

shoqerohet me reduktim të ndjeshëm të tarifave të terminimit (41-62%) dhe me heqjen e tarifës për thirrje (aktualisht 0.38 lek/thirrje).

Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) dhe reduktimi i përshkallëzuar është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e lejuar nga Ligji 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pika 2.

Tarifat e terminimit në rrjetet e operatorëve alternativë fikse dhe AMC propozohen të barazohen me ato të Altelecom duke filluar nga 1.01.2015, pra të jene me 1 segment dhe simetrike midis të gjithë operatorëve të rrjeteve publike që ofrojnë telefoni fikse në Shqipëri. Heqja e asimetrisë është në linjë dhe me rekomandimet e BERC (më parë ERG) pasi shumica e operatorëve kanë vite tashmë që janë në treg dhe nxit një konkurrencë më të drejtë dhe thjeshtëzim të tarifimit për pajtimtarët e telefonisë fikse.

Tabela 8: Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të OA dhe AMC për AMC fikse (2010-2015)

	2010	1.01.2014	1.09.2014	1.01.2015	1.07.2015
OA					
Lokal	1.5-1.95	1.5	1.34	1.52	0.7
Mesatare-Njefish/dyfish	2.5-3.25/3.5	2.42	1.77		
Tarife fikse per thirrje	0.83	0.53	0.38	0.23	0
AMC					
Terminimi lek/minute	1.50 ose 2.5	1.34	1.19	1.52	0.7
Tarife fikse per thirrje		0.53	0.38	0.23	0

Tarifat pa TVSH

5. Efektet e pritshme

Tabela e mëposhtëme paraqet reduktimet e tarifave të terminimit të thirrjeve telefonike në rrjetet fikse dhe AMC për AMC Fiks, aktuale dhe të propozuara për dy vitet në vijim.

Tabela 9: Ndryshimet në përqindje të tarifave të terminimit në rrjetet fikse (1.09.2014-2015)

	1.09.2014	1.01.2015	1.07.2015	Ndryshimi në %	
				1.01.2015/2014	1.07.2015/2014
<u>Albtelecom</u>					
Lokal/Njefish	1.19	1.52	0.70	28%	-41%
Dyfish	1.85			-18%	-62%
POI	12	12	2		
<u>OA</u>					
Lokal	1.34	1.52	0.70	13%	-48%
Mesatare-Njefish/dyfish	1.77			-14%	-60%
<u>AMC</u>					
Terminimi lek/minute	1.19	1.52	0.70	28%	-41%
Tarife fikse per thirrje	0.38	0.23	0.0	-39%	-100%

Tarifat pa TVSH

Nga tabela vihet re se reduktimet variojnë nga 41-62% për tarifën e terminimit të thirrjeve në lek/minutë dhe 100% për tarifën për thirrje, e cila propozohet të hiqet më 1.07.2015. Ndryshimet e propozuara pritet të japin një shtysë të re në konkurrencën në treg për thirrjet telefonike fikse paralelisht me thjeshtëzimin e tarifimit të operatorëve me njëri-tjetrin dhe për pajtimtarët. Këto reduktime synojnë dhe reduktimin e stimujve për problematikën e tarifave të ndryshme on-net-off-net të ngjashme me tregun celular dhe rrisin stimujt për tarifim unifik në rrjetet fikse dhe celulare pavarësisht destinacionit fiks/celular. Reduktimet e tarifave të terminimit në rrjetet fikse janë në linjë edhe me reduktimet e kryera tashmë (vendimet e AKEP më 13.03.2014) dhe ato të propozuara (shiko Analiza e tregut celular) për tarifën e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Niveli i tarifave të terminimit në rrjetet fikse në Shqipëri në Korrik 2015 pritet të arrijë nivelin mesatar të vendeve të BE/BEREC në 2014, pra me një sfazim 1.5 vjet.

Tarifa e propozuar për terminim në rrjete fikse në Korrik 2015 (0.7 lek/minutë) është më e lartë se tarifa mesatare benchmark sipas LRIC të pastër në rrjete fikse (0.16 lek/minutë) e aplikuar në vende të BE, dhe kjo zgjedhje e AKEP është bazuar në karakteristikat e tregut fiks në Shqipëri:

- telefonia fikse ka zhvillim (mbulim dhe përdorim) shumë më të ulët se në vendet e rajonit dhe BE, ndërsa telefonia celulare në Shqipëri ka shumë më tepër karakteristika të ngjashme me vendet e rajonit dhe BE. Këto karakteristika ndikojnë në nivelin e kostove duke cuar në kosto më të larta për njësi në Shqipëri për rrjetet fikse, ndërsa janë të ngjashme për rrjetet celulare në raport me vendet e rajonit dhe BE;
- objektivi për të rritur stimujt për investime/modernizime në rrjete fikse, jo vetëm për telefoni fikse por sidomos për akses broadband fiks.

Njëkohësisht reduktimi i propozuar i pikave të interkoneksionit të Albtelecom në 1.07.2015, nga 12 në 2, krijon kohë të mjaftueshme për OA për përshtatje me zhvillimet e fundit dhe investimet e Albtelecom, duke krijuar njëkohësisht stimuj për Albtelecom për vazhdimin e investimeve në modernizim të rrjetit fiks që duhet të sjellë përfitime për gjithë tregun në tërësi, dhe sidomos për përdoruesit fundorë.

Aneks 1: Lista e Shkurtimeve të Shteteve

Simboli	Shteti
AT	Austri
BE	Belgjik
BG	Bullgari
CH	Zvicër
CY	Qipro
CZ	Çeki
DK	Danimarkë
DE	Gjermani
EE	Estoni
EL	Greqi
ES	Spanje
FI	Finlandë
FR	Francë
HR	Kroaci
HU	Hungari
IE	Irlandë
IS	Islandë
IT	Itali
LT	Lituani
LV	Letoni
LU	Luksemburg
FYROM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
NL	Hollandë
NO	Norvegji
PL	Poloni
PT	Portugali
RO	Rumani
RS	Serbi
SE	Suedi
SI	Slloveni
SK	Sllovaki
TR	Turqi
UK	Mbreteria e Bashkua(Angli)

Aneks 2: Lista e pyetjeve për këshillim publik

- 1. A keni komente në lidhje me tarifat mesatare të vendeve të BE, vendeve të referuara nga BEREC dhe vendeve me LRIC të pastër?**
- 2. Cili/cilat nivele benchmark nga Tabela 3 gjykoni se janë më të përshatshme për t'u aplikuar në Shqipëri dhe pse?**
- 3. Cili është opinionimi juaj në lidhje me nivelet dhe afatet e tarifave të terminimit/origjinimit/tranzitimit të propozuara nga AKEP për Albtelecom ?**
- 4. Cili është opinionimi juaj në lidhje me reduktimin e numrit të pikave të intrekoneksionit (POI) të Albtelecom në Korrik 2015?**
- 5. Cili është opinionimi juaj në lidhje me nivelet dhe afatet e tarifave të terminimit të propozuara nga AKEP për operatorët alternativë dhe AMC për AMC fiks?**
- 6. A jeni dakort me pritshmëritë e AKEP se reduktimi i propozuar i tarifave të terminimit do të ketë efekte pozitive në stimujt për investime në rrjete fikse dhe nivelin e tarifave me pakicë dhe politikat tarifore me pakicë?**